



*KUVENDI KOMUNAL PRISHTINË *MUNICIPALITY ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINE PRISHTINA*

Në bazë të nenit 13.7, 14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe 19.2 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, dt. 10. 09.2003, nenit 3, par. 1, pika "b", të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, nenit 19, par.1, pika "b", dhe nenit 40, par. 3, pika II, të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2005 merr

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PROPOZIMPLANIT RREGULLATIV PËR LAGJEN
"DODONA" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Propozimplani rregullativ i lagjes "Dodona" në Prishtinë.
Propozimplani, nga par. 1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe ajo grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërse të këtij Vendimi.

Neni 2

Propozimplani, nga neni 1 i këtij Vendimi, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit publik.
Shqyrtimi publik i Propozimplanit rregullativ, sipas këtij Vendimi, zgjat 30 ditë, duke llogaritur nga dita e parë vijuese, pas miratimit të tijë nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
Organizimin e shqyrtimit publik të Propozimplanit, sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të Propozimplanit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë, do t'i kryejë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij plani, në mënyrë që i njëjti t'i prezentohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 4

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 35-14467 dt. 21.06.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri